



Financuar nga
Bashkimi Evropian

TË DREJTAT E PUNËS SË GRAVE SHITATËZËNA DHE NËNAVE TË REJA NË VERI TË KOSOVËS





Financuar nga
Bashkimi Evropian

Titulli i hulumtimit: Të drejtat e punës së grave shtatzëna dhe nënave të reja në veri të Kosovës

Projekti: Mbështetje për një pozitë më të mirë të grave shtatzëna dhe nënave të reja

Përgatitur nga: Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike - ACDC

Mohim përgjegjësie: Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit "Mbrotjtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve vulnerabël në tregun e punës". Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian', ATRC ose BIRN KOSOVË.

Viti i publikimit: Prill 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

LYDEEV E LEKUPYDIES

HYRJE 5

PRAPAVIJA 6

ANALIZA E HULUMTIMIT 8

KONKLUZION 26

REKOMANDIME 27

HYRJE

"Mbrotjtja e lehonisë është një e drejtë themelore e njeriut dhe një element i domosdoshëm i politikës gjithëpërfshirëse punë-familje."

Ky studim synon ngritjen e vetëdijes për barazinë gjinore me fokus të veçant në fuqizimin e grave, duke filluar nga fuqizimi ekonomik i grave, si një çështje thelbësore në progresin e shoqërisë në Kosovë.

Ndër të tjera, hulumtimi përfshinë një analizë të vlerësimit të ndikimit të stereotipeve dhe mjedisit patriarkal, që në mënyrë të pashmangshme kanë ndikim në pozitën e përgjithshme të gruas në shoqërinë tonë. Kjo sepse, është një fakt i njohur, mesatarisht, gratë fitojnë më pak se burrat në të njëjtin vend pune dhe hasin në paragjykime të ndryshme që i pengojnë ato të angazhohen në profesione që tradicionalisht u atribuohen burrave. Gratë janë të përfaqësuara në një numër disproporcionalisht më të vogël në pozitat drejtuese si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe, natyrisht, ato i kushtojnë më shumë kohë kujdesit për fëmijët, të moshuarit në punët shtëpiake dhe të shtëpisë, krahasuar me burrat.

Në gjithë Kosovën, nevojat specifike të grave janë neglizhuar, veçanërisht në fushën e punësimit dhe në mesin e grave nga grupet e synuara të ndjeshme si nënat e vetme, gratë shtatzëna dhe nënat e reja. Gratë që vijnë nga komunitetet jo-shumicë janë veçanërisht të prekura nga ky problem. Arsyeja kryesore është se ato nuk janë të informuara në mënyrë adekuate për legjislacionin që duhet të zbatohet për të gjithë, pavarësisht nga vendbanimi, përkatësia etnike apo ndonjë kriter tjetër. Studimi synon fuqizimin e pozitës së gruas, si dhe ndërgjegjësimin për të drejtat e punës dhe pushimin e lehonisë. Vëmendje e veçantë i kushtohet grave më vulnerabël në këtë grup: gratë shtatzëna, nënat në lindje dhe nënat e reja dhe beqare.

Rreth projektit

"Avokimi për një pozitë më të mirë të grave shtatzëna dhe nënave të reja"

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të ofrojë mbështetje për gratë në Kosovë duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mosdiskriminimit në fushën e ligjit të punës, si dhe duke identifikuar qëndrimin e qytetarëve, por në radhë të parë të grave, për të drejtat dhe detyrimet e punonjësit. Grupet e synuara janë gratë e reja, gratë shtatzëna dhe nënat beqare që jetojnë në veri të Kosovës. Proekti financohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, në kuadër të projektit "Mbrotjtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cënueshme në tregun e punës", i zbatuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC në partneritet me BIRN Kosovë.

PRAPAVIJA

Ligji i Punës ¹ si dhe Ligji Nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, të dy ligjet tentuan t'i përshtatin nevojat e grave në mbrojtjen e veçant të amësisë dhe fëmijëve, në mënyrë që të krijohen kushte sociale, kulturore, arsimore, materiale dhe të tjera, përmirësimin e ushtrimit të të drejtave për një jetë dinjitoze, me referencë të veçant për mbrojtjen e nënave në punë. Përgjegjësia për t'u kujdesur për fëmijët dhe mirëqenien e tyre është detyrë e prindërve, por është edhe detyrë e shoqërisë të sigurojë parakushtet për zhvillimin më të mirë të fëmijëve.

Shoqëria i kushton vëmendjen e duhur familjes përmes sistemit ligjor dhe financiar dhe shteti është i detyruar t'u sigurojë prindërve kohë të mjaftueshme për kujdesin ndaj fëmijëve dhe sigurimet shoqërore. Të drejtat në fushën e mbrojtjes së nënave gjatë shtatzënisë dhe të drejtat e prindërve janë bërë një e drejtë e përgjithshme që realizohet sipas rregulloreve kombëtare të çdo vendi. Ligjet e punës rregullojnë mbrojtjen e grave shtatzëna dhe nënave në gjdhënie; megjithatë, prindërit shpesh nuk janë mjaftueshëm të informuar për të drejtat e tyre dhe e kanë të vështirë të manovrojnë burokracinë. Prandaj, është e rëndësishme t'u sqarohet prindërve - veçanërisht grave, nënave gjdhënëse dhe baballarëve, por edhe prindërve me fëmijë me aftësi të kufizuara në zhvillim se cilat të drejta u takojnë gjatë dhe pas shtatzënisë.

Kështu, ky studim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë të pozitës së përgjithshme të gruas në Kosovë, veçanërisht në aspektin e stereotipeve gjinore, të cilat vazhdojnë të kenë pasoja të rënda jo vetëm tek gratë që janë të ekspozuara drejtpërdrejt ndaj tyre, por edhe në të gjithë familjen. Situata u përkeqësua më tej gjatë pandemisë COVID-19 dhe sigurisht rriti pabarazinë gjinore, duke pasur parasysh se pandemia preku edhe sferën ekonomike, duke rritur numrin e grave që humbën punën ose vuanin nga puna e papaguar në shtëpi, e cila ndër të tjera, rriti rrezikun e dhunës ndaj grave në të gjitha format.

Ndër të tjera, ky hulumtim do të tregojë se pjesëmarrja e barabartë e grave në të gjitha sferat e jetës publike dhe shoqërore, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta të punësimit për gratë dhe burrat, duke i'u referuar veçanërisht mbrojtjes së lehonisë, është me rëndësi vendimtare, jo vetëm në drejtim të përmirësimit të pozitës së gruas por është edhe thelbësore për zhvillimin dhe prosperitetin e mbarë shoqërisë në Kosovë. Prandaj është thelbësore që si shoqëri të bëjmë përpjekje që do të na shpien në kohë më të mira, më të begata dhe më të drejta përmes përmirësimit të kornizave ligjore, zbatimit adekuat të ligjeve ekzistuese dhe kundërshtimit vendimtar dhe tejkalimit të paragjyqimeve të dëmshme.

¹ Ligji i punës Nr. 03/L-212

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit sasior

Tematikisht, ky hulumtim shqyrton dy aspekte të këtij problemi. Anketa online dhe ballë për ballë është realizuar në periudhën janar-shkurt 2023. Janë pyetur gjithsej 204 qytetarë të nacionaliteteve të ndryshme nga Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani. Në total, 100% e të anketuarve ishin femra për mostër. Numri më i madh i të anketuarve ishin personat e moshës 31-40 vjeç. Pyetësi përbëhej nga 30 pyetje, dhe mostra ishte i qëllimshëm dhe kuotë. Intervali i besimit është +/-5. Është e nevojshme të theksohet se, duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare për strukturën demografike të popullatës së synuar, d.m.th të popullsisë serbe në Kosovë, përfaqësimi i mostrës mund të shihet në mënyrë tentative.

Pjesa e dytë e hulumtimit ka të bëjë me perceptimet e qytetarëve femra që janë realizuar përmes fokus grupeve me gra nga grupe specifike dhe të ndjeshme të synuara: nënat beqare, gratë shtatzëna dhe nënat gjdhënëse. Në fokus grupe, ofruan një prezantim më të detajuar të perspektivës së grave kur diskutohet për barazinë gjinore, me theks të veçantë në fuqizimin e grave, duke filluar nga fuqizimi ekonomik, si një komponentë thelbësore në zhvillimin e

shoqërisë në Kosovë. Përmes fokus grupeve u shprehën nevojat specifike të grave në mbarë Kosovën, veçanërisht në fushën e punësimit dhe mungesën e njohurive për legjislacionin që duhet të zbatohet për të gjithë.

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor

Fokus grupet

Koha: Hulumtimi është kryer nga 01.02. 2023 deri më 28.02. në vitin 2023

Instrumenti kërkimor: Udhëzuesi për diskutimin e 12 njësive tematike.

Numri i fokus grupeve: 4 (fokus grupe me akterët përkatës, d.m.th. me gra nga institucione dhe organizata të ndryshme joqeveritare, por edhe qytetarë të thjeshtë që na dhanë një pasqyrë të situatës aktuale në terren për këtë temë të ndjeshme).

Numri total i pjesëmarrësve: 45 (dyzet e pesë).

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve: variabla gjinore, moshë, vendbanimi, niveli arsimor.

85% arsim të lartë,

100% pjesëmarrëse femra

18+ moshë

ANALIZA E HULUMTIMIT


Për të kuptuar gjendjen faktike në fushën e barazisë gjinore me referencë të veçantë për pozitën e gruas në ligjin e punës dhe mbrojtjen adekuate të lehonisë, hulumtimi do të merret me perceptimet e qytetarëve nga grupet e synuara specifike dhe të ndjeshme: gratë shtatzëna dhe të reja dhe nënat gjidhënëse.

Gjetjet e hulumtimit, ku janë përfshirë 204 të anketuar, janë paraqitur në seksionin që vijon. Ky seksion do të përfshijë gjithashtu rezultatet e nxjerra nga katër fokus grupe të zhvilluara për të diskutuar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të ligjit të punës për grupet vulnerabël në tregun e punës.


PËRSHKRIMI I MOSTRËS

Struktura e të anketuarve është e tillë që përfshinë të anketuar nga të katër komunat në veri të Kosovës me këtë përqindje: numri më i madh është nga Mitrovica e Veriut (30%), pasuar nga Leposaviqi (28%), Zveçani (24%) dhe Zubin Potoku (18 %).

Gratë e moshës 31 deri në 40 vjeç përbënin shumicën e të anketuarve nga mostra e përgjithshme (afërsisht 60%), të ndjekura nga ato të moshës 18 deri në 30 vjeç (20%) dhe ato të moshës 41 vjeç e lart (pak mbi 20%).




Niveli i arsimimit të të anketuarve është i lartë. Siç mund të vërehet nga grafiku, 38% e të anketuarve kishin diplomë bachelor të ndjekur nga 43% me master, 15% kishin arsim të mesëm dhe 4% kishin doktoraturë. Kjo nënkuptohet edhe nga fakti se nuk kemi pasur të anketuar që kanë përfunduar vetëm shkollën fillore.




Për më tepër, nga përgjigjet e përgjithshme, serbët përbënin përqindjen më të madhe të të anketuarve (75%), të ndjekur nga boshnjakët me afro 20%, shqiptarët me 3%, dhe romët me rreth 2%.

Sa i përket statusit të punësimit, të punësuarit përbëjnë numrin më të madh të të anketuarve, afër 60%, pasuar nga të papunët 20%, ndërsa studentët dhe amviset përbëjnë një përqindje më të vogël.


PËRKATËSIA ETNIKE



STATUSI I PUNËS



KATEGORIA




Për sa i përket grupit të synuar të cilit i përket, shumica e të anketuarve nuk pranuan të përgjigjen dhe besojmë se këto janë gra që nuk i përkasin asnjërës prej kategorive të ofruara, por kur diskutojmë këtë temë sigurisht që kanë përvoja (personale ose nga mjedisi i tyre i afërt). Objektivi i dytë më i përfaqësuar, që ishin nënat beqare me rreth 24%, të ndjekura nga nënat gjidhënëse me rreth 23%, dhe më pas gratë shtatzëna me rreth 14%.

PERCEPIMI I PROBLEMEVE KRYESORE

Që në fillim të hulumtimit cilësor dhe sasior, ne kemi parë nëse dhe sa mirë legjislacioni i Kosovës i rregullon të drejtat e grave shtatzëna, nënave në punë dhe nënave beqare. Gjegjësisht, numri më i madh, 65%, e të anketuarve, janë përgjigjur se nuk mendojnë se ligjet e Kosovës i rregullojnë siç duhet të drejtat e grave shtatzëna dhe nënave me gji, ndërsa 25% e të anketuarve janë shprehur të pasigurt dhe vetëm 10% janë përgjigjur "po".

A MENDONI SE LEGJISLACIONI I KOSOVËS KA RREGULLUAR MJAFTUESHËM TË DREJTAT E GRAVE SHTATZËNA, TË NËNAVE SHTATZËNA DHE TË NËNAVE BEQARE?



Të anketuarat nga pjesa sasiore dhe cilësore e hulumtimit ranë dakord për një gjë - për shkak të marrëdhënieve tradicionale dhe roleve gjinore në shoqërinë tonë, vendi i punës është vendi ku gratë përjetojnë më shumë pabarazi. Gratë në përgjithësi përballen me pabarazinë më të madhe në tregun e punës dhe në favor të kësaj flet Ligji i Punës, i cili përcakton shumë ngushtë të drejtat për lejen prindërore, konkretisht të drejtat e babait të fëmijës.


Ky ligj i mundëson babait të fëmijës të shfrytëzojë vetëm dy ditë pushim me pagesë gjatë lindjes apo adoptimit të fëmijës, përkatësisht dy (2) javë pushim pa pagesë pas lindjes apo adoptimit të fëmijës derisa fëmija të mbush moshën tre vjeçare. (3) dhe është evidente se ky kuadër ligjor kërkon rishikim urgjent. Megjithatë, në realitet, një çështje shumë më e madhe për nënat (se kjo) është fakti se të drejtat e tyre ligjore, të garantuara me Ligjin e lartpërmendur, shpesh nuk respektohen, kryesisht nga punëdhënësit, veçanërisht në veri të Kosovës. Ky problem lidhet me mangësitë e Ligjit të Punës.

Sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, punëtorët gra kanë të drejtë në dymbëdhjetë (12) muaj pushim të lehonisë. Gjatë gjashtë (6) të para të pushimit të lehonisë, punëdhënësi është i detyruar të paguajë shtatëdhjetë për qind (70%). Tre (3) muajt në vijim të pushimit të lehonisë do të paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim prej pesëdhjetë për qind (50%) të pagës mesatare të aplikueshme, 3 muaj pa kompensim. Gruaja e punësuar ka të drejtë, sipas këtij ligji, të vazhdojë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muaj të tierë pa pagesë.

Por, praktika tregon një imazh krejt tjetër nga ajo që kërkon ligji. Pak organizata në pjesën veriore të Kosovës, sipas bashkëbiseduesve tanë, janë të gatshme të presin për punëtorë më shumë se 3 muaj pas lindjes. Pas tre muajve të pushimit të lehonisë, punëdhënësit i japin nënës mundësinë për t'u rikthyer në punë ose, më shpesh, punësojnë një punonjëse të re për ta zënë vendin e saj. Në këtë drejtim, gratë nuk kanë asistencë dhe mbrojtje të mjaftueshme për të siguruar që të drejtat e tyre do të respektohen plotësisht, edhe nëse ato zgjedhin të krijojnë ose rrisin familjet e tyre. Prandaj, çështja e shtatzënisë dhe gjithçka që shkon së

bashku me shtatzëninë, lindjen e fëmijës dhe periudhën pas lindjes nuk duhet të shihet si deri më tani, veçanërisht nga punëdhënësit - si një pengesë, një e metë dhe pengesë në një karrierë të mëtejshme, përkundrazi, se sa si një situatë e vetme nga e cila përfiton jo vetëm zhvillimi i shoqërisë, i vendit, por edhe i familjes dhe i të gjitha atyre vlerave që ne të gjithë mbrojmë.

SA I NJIHNI TË DREJTAT E GRAVE SHTATZËNA, GRAVE GJIDHËNËSE DHE BEQAREVE QË KUJDESEN PËR FËMIJËT NËN 3 VJEÇ?



Përafërsisht 30% e grave u përgjigjën se janë të njohura me të drejtat ligjore të grave shtatzëna, nënave gjidhënëse dhe nënave beqare që kujdesen për fëmijët nën moshën tre vjeç, e ndjekur nga 40% që thanë se ishin disi të njohura dhe 30% që thanë se ishin ose aspak ose jo plotësisht të panjohur.

Përvoja të ngjashme ndahen nga të intervistuarit tanë gjatë pjesës cilësore të hulumtimit - gratë gjatë shtatzënisë dhe nënat gjidhënëse duhet të jenë një kategori punëtore e mbrojtur posaçërisht. Ligji i Punës u garanton grave shtatzëna të drejtën

e mbrojtjes nga diskriminimi gjatë krijimit të lidhjes së punës, gjatë punës për punëdhënësin, si dhe kur përfundon kontrata e punës.


Ligji i Punës e ndalon punëdhënësin të vendosë një grua në një pozitë të pafavorshme në raport me punëtorët e tjerë për shkak të shtatzënisë. Punëdhënësit i ndalohet të refuzojë të punësojë një grua ose të anulojë kontratën e saj të punës për shkak të shtatzënisë.

Përvoja të shumta nga praktika tregojnë se gjatë punësimit, punëdhënësit i pyesin kandidatet femra për statusin e tyre familjar, synimet e tyre për të pasur fëmijë dhe shqetësime të tjera të statusit të krahasueshëm, gjë që paraqet diskriminim të drejtpërdrejtë gjinor nga punëdhënësi. Gjatë procesit të zgjedhjes së një kandidati për një vend pune (intervistë, testim, anketë etj.) dhe lidhjes së kontratës së punës, punëdhënësi nuk duhet t'i kërkojë punonjësit informacione që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me marrëdhënien e punës. Gjithashtu, punëdhënësi mund të kërkojë informata për shtatzëninë e një gruaje vetëm nëse punëtorja kërkon në mënyrë specifike një të drejtë të caktuar me ligj ose rregullore tjetër për të mbrojtur shtatzëninë e saj.

Zgjidhja e problemeve të tilla kërkon kryesisht një politikë të qartë të popullsisë. Riprodhimi nuk duhet të jetë sakrificë; në vend të kësaj, ajo duhet të bazohet në parimet e sigurimit të cilësisë së jetës. Kur bëhet fjalë për kulturën e lindjes së fëmijëve, politika e popullsisë duhet të përmbajë masa cilësore dhe sasiore, të jetë ekspansive dhe rishpërndarëse, të përmbajë masa sociale, masa të politikës fiskale, masa që lehtësojnë mëmësinë. Përveç kësaj, si pjesë e politikës së popullsisë, është thelbësore të krijohen mënyra efektive për të rritur ndërgjegjësimin e grave për

të drejtat e garantuara për to dhe për t'i trajnuar ato se si t'i mbrojnë ato të drejta në rast se ato shkelen.

Shoqëria pret që gratë të lindin si një mekanizëm për ruajtjen e stabilitetit të një komuniteti shoqëror. Është e nevojshme të sigurohet një mjedis që nuk do t'i ekspozojë pa nevojë gratë shtatzëna përballë vështirësive dhe do t'u krijojë pengesa që do t'ua vështirësojnë planifikimin e shtatzënisë, lindjes dhe periudhës pas lindjes.



Kur flasim nëse ndonjë nga të drejtat e të anketuarve tanë ishte mohuar apo shkelur nga punëdhënësi i tyre, deri në 39% thanë po, 43% pohuan se nuk ishin të sigurt, ndërsa 18% e grave treguan se nuk kishin përvoja negative me punëdhënësin e tyre. Ky konkluzion u arrit nëpërmjet hulumtimit cilësor dhe sasior.

Është absolutisht e vërtetë që, ndërkohë që punëdhënësit duan një bashkëpunëtor të besueshëm tek i cili mund të mbështeten gjithmonë - edhe pas orarit të punës dhe në ditët jo pune, punonjëset femra ëndërrojnë për një shef të drejtë. Në praktikë, megjithatë,

ndodh diçka krejtësisht ndryshe, sipas të anketuarve të pjesës sonë cilësore të hulumtimit. Kompanitë shpesh mbrojnë interesat e tyre dhe duan qëndrueshmëri në fuqinë e tyre punëtore, kështu që nuk është brenda të drejtave të tyre, për shembull, të punësojnë një grua shtatzënë ose të zëvendësojnë një punonjëse ekzistues që papritur e gjeti veten në një gjendje të re. Për të zgjidhur statusin e tyre, gratë shtatzëna shpesh u propozojnë punëdhënësit mundësinë e rishpërndarjes së orarit të punës ose futjes së punës fleksibile, gjë që vetëm sa e përkeqëson më tej çështjen. Në Kosovë, veçanërisht në pjesën veriore, realiteti i biznesit është i ashpër, gjë që ka treguar se vetëm pak punëdhënës miratojnë orar fleksibël të punës dhe shumica e tyre nuk lejojnë punën nga shtëpia. Prandaj, ndoshta edhe me të drejtë, publiku shpesh ngre pyetjen se përse disa punëdhënës nuk i pëlqejnë shumë gratë shtatzëna dhe shkelin të drejtat e tyre. Një nga arsyt pse punëdhënësit shmangin punësimin ose mbajtjen e një gruaje që është shtatzënë ose planifikojnë një shtatzëni është sepse atyre u mungojnë burimet e duhura administrative dhe financiare për të përballuar një skenar të tillë.

Në lidhje me pyetjen e mëparshme, gratë dhanë përgjigje të ndryshme kur u pyetën nëse organizata/kompania për të cilën punojnë është në përputhje me rregullat dhe legjislacionin që ofron të drejta të caktuara për gratë gjatë shtatzënisë, nënat gjidhënëse dhe nënat beqare. Ndërsa gratë që morën pjesë në




anketë thanë se punëdhënësit e tyre më së shumti i përmbahen rregullave ligjore që u garantohen grave shtatzëna dhe nënave në lindje - pak më shumë se 50%, gratë që morën pjesë në hulumtimin cilësor u përgjigjën krejt të kundërtën.

Ligji aktual për Parandalimin e Diskriminimit thotë qartë: Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në bazë të gjinisë, statusit martesor ose familjar, shtatzënisë, lindjes dhe prindërimit. (Nr.05/L-020).

Një grua gëzon mbrojtje gjatë shtatzënisë dhe pushimit të lehonisë dhe ka një vit në dispozicion të saj për t'u kujdesur për një fëmijë të porsalindur. Mirëpo, ashtu si ligjet e tjera vendore, problemi i ligjeve në këtë rast është edhe moszbatimi i tyre. Për shkak se ligji nuk i mbron më, gratë pushohen nga puna gjatë shtatzënisë apo pushimit të lehonisë dhe rasti më tipik është që ato pushohen nga puna sapo kthehen nga leja e lehonisë. Sipas përvojës së bashkëbiseduesve tanë në pjesën cilësore të hulumtimit, ndodh që kur një grua kthehet në punë, të caktohet në një pozicion më të ulët, me një pagë më të ulët, që është shkelle e drejtpërdrejtë e të drejtave të saj si punonjëse - dhe përfshin edhe mobingun. Frika është një çështje tjetër. Gratë shtatzëna dhe nënat e reja në sektorin privat dhe publik janë gjithashtu të prekura nga kjo torturë, megjithëse shifrat as që fillojnë të tregojnë se sa prej tyre e përjetojnë vërtet atë. Shteti bëri disa përparime për të përmirësuar masën e politikës së popullsisë. Ekziston një kornizë ligjore, organet kompetente po punojnë në korniza të reja ligjore për kompensim adekuat për pushimin e shtatzënisë dhe lehonisë (që, pa dyshim, varet në masë të madhe nga vullneti i mirë i punëdhënësve). Megjithatë, në të njëjtën kohë, ka narrativa dhe stereotipe të rreme që ndjekin gratë, duke i thënë se roli i tyre më i rëndësishëm është lindja dhe kujdesi për familjen.

Ka dallime ndërmjet pjesës cilësore dhe sasiore të hulumtimit edhe në këtë pjesë, bazuar në përfundimet e mëparshme dhe në lidhje me pyetjen paraardhëse. Ndërsa të anketuarit në anketë në përgjithësi thanë se ose punëdhënësi i tyre i mbështeti plotësisht para, gjatë dhe pas shtatzënisë (30%) ose se ata nuk e dinin nëse dhe në çfarë mase kishin mbështetje nga punëdhënësi i tyre (e njëjta përqindje e të anketuarve, 30%), femrat në studimet e pjesës cilësore kanë një mendim krejtësisht të ndryshëm.


A JU KA MBËSHTETUR MJAFTUESHËM PUNËDHËNËSI PËR TË CILIN PUNONI GJATË SHTATZËNISË DHE PAS KTHIMIT NË PUNË?



Të anketuarit tanë theksuan se një çështje madhore është largimi i grave nga puna pas pushimit të lehonisë si dhe mohimi i së drejtës për punësim grave që janë shtatzëna ose që planifikojnë të mbeten shtatzënë së shpejti. Punëdhënësit janë më së shumti përgjegjës për këto devijime të normave pozitive, prandaj pa inkurajimin dhe ndihmën e duhur prej tyre, ne nuk jemi në gjendje të diskutojmë një rritje të nivelit të lindjeve dhe një politikë efektive të popullsisë. Është thelbësore që sistemi juridik të mos jetë i rregulluar që të ketë efektin e kundërt.


Shumica e të anketuarve - mbi 60% të cilët janë pyetur nëse besojnë se gratë janë të dekurajuara që të kthehen në punët e tyre kryesore në organizatat ose kompanitë e tyre pas pushimit të lehonisë - janë përgjigjur pozitivisht. Vetëm 10% e të anketuarve thanë se nuk e dinin, ndërsa mbi 30% thanë se në përgjithësi janë të dekurajuara që të kthehen në punën e tyre kryesore pas pushimit të lehonisë. Gjetjet e pjesës cilësore të hulumtimit janë të ndërlidhura edhe me ato sasiore, siç dëshmohet nga shembujt e shumtë në të cilët gratë në veri janë transferuar në pozita më të ulëta pas lindjes dhe kthimit në punë, me shpjegimin se kanë qenë teknologjikisht të tepërta sepse këto gra shiheshin si fillestare pasi kishin marrë një vit pushim sepse kanë një fëmijë të vogël. Ligji nuk i mbron më gratë nga vendimet arbitrare të punëdhënësve të tyre kur mbaron pushimi i lehonisë, gjë që shpesh rezulton në shkarkimin kur ato kthehen në punë.

A MENDONI SE GRATË JANË TË DEKURAJUARA QË TË KTHEHEN NË PUNËN E TYRE KRYESORE NË ORGANIZATËN/KOMPANINË E TYRE PAS PUSHIMIT TË LEHONISË?



Përkundrazi, gratë rrallëherë zgjedhin të tërheqin publikisht vëmendjen ndaj shkeljes së të drejtave të tyre të punës që hasin pas pushimit të lehonisë. Për shkak të sistemit patriarkal që ka formësuar shoqërinë tonë dhe ka vendosur rolet e grave si vartëse, është e turpshme të shtrohen çështjet me të cilat ato përballen. Gratë më të reja janë zakonisht më të hapura për të diskutuar këtë çështje, veçanërisht nëse familjet e tyre janë burimet kryesore të mbështetjes.

A MENDONI SE SHTATZËNIA APO KUJDESI PËR FËMIJËT E VEGJËL KA NDIKIM NË VENDIMET E PUNËDHËNËSVE NË LIDHJE ME AVANCIMIN NË KARRIERË APO PROMOVIMIN E GRAVE?



Përgjigjet e grave ndaj pyetjes nëse shtatzënia apo kujdesi për fëmijët e vegjël ka një ndikim në vendimet e punëdhënësve për zhvillimin e karrierës ishin absolutisht unanime, me rreth 85% të grave që thonë se ka dhe vetëm 15% thonë se nuk ka. Kjo është plotësisht në përputhje me pjesën cilësore të hulumtimit, ku gratë pranuan se u duhet një kohë e gjatë që të përparojnë në punët e tyre pas lindjes, kthimit nga pushimi i lehonisë dhe, nëse janë me fat, të mos promovohen në pozitat inferiore brenda organizatës. Nga këndvështrimi i nënave që janë kthyer në punë pas pushimit të lehonisë, gratë

mendojnë se kjo është mënyra më e mirë për të përshkruar situatën në shumë kompani dhe organizata në pjesën veriore të Kosovës. Fakti se diskriminimi i grave pas kthimit nga pushimi i lehonisë është lloji më i përhapur i diskriminimit, tregon se sa është përhapur kjo çështje. Gratë stigmatizohen si më pak produktive dhe më të shqetësuara për familjet e tyre kur kthehen nga kjo lloj pushimi. Por, me pak ndihmë dhe mirëkuptim, gjërat mund të kthehen shpejt në normalitet ose, më shpesh, edhe të përmirësohen për ta.

Gratë në pjesën cilësore dhe sasiore të hulumtimit kanë të njëjtat mendime kur diskutojmë angazhimin më orar fleksibiliteti në punë, si një zhvillim pozitiv për karrierën e grave gjatë shtatzënisë dhe gjatë gjithë periudhës së gjdhënies. Rreth 97% e grave ranë dakord se një nga hapat themelorë që qeveria duhet të bëjë për të inkurajuar lindjen e fëmijëve është përshtatja e orarit të punës për nënat si një mjet ndihmës kur nënat të kthehen në punë. Kjo duhet të zbatohet veçanërisht për nënat me një fëmijë, të cilat e kanë të vështirë të vendosin për një fëmijë të dytë për shkak të mungesës së ndihmës dhe mbështetjes, veçanërisht nga punëdhënësit e tyre.


A MENDONI SE ANGAZHIMET MË FLEKSIBILE TË PUNËS DO TË ISHIN NJË ZHVILLIM POZITIV PËR KARRIERËN E GRAVE GJATË SHTATZËNISË DHE USHQYERJES ME GJI?



Kjo punë me kohë fleksibiliteti do t'u mundësonte nënave të reja të organizoheshin më lehtë menjëherë pas kthimit në punë. Kjo sigurisht do të ishte një nga masat stimuluese që do të nxiste rritjen e numrit të fëmijëve.

Sipas përgjigjeve të grave, është e qartë se kjo masë duhet të zbatohet; megjithatë, çështja me gatishmërinë e punëdhënësve për të ofruar orare fleksibël të punës është një lloj problemi krejtësisht i ndryshëm. Megjithatë, shumë pak punëdhënës janë të gatshëm të ofrojnë orar fleksibël të punës dhe akoma më pak janë të gatshëm të lejojnë të punojnë nga shtëpia gjatë gjdhënies ose shtatzënisë.

A MENDONI SE GRATË SHTATZËNA, NËNAT GJIDHËNËSE DHE NËNAT BEQARE JANË MË TË PAMBJROJTURAT NË SEKTORIN PRIVAT DHE JOQEVERITAR NË KOSOVË?




Edhe në këtë rast përgjigjet e pjesës kualitative dhe sasiore të hulumtimit janë plotësuese – pjesa më e madhe e të anketuarve, deri në 75%, kanë thënë se gratë shtatzëna, nënat gjdhënëse dhe nënat beqare janë më të pambrojturat në sektorin privat dhe joqeveritar në Kosovë. Çështja më e rëndësishme e pazgjidhur në Kosovë vazhdon të jetë shkalla e lartë e papunësisë së femrave dhe kohëzgjatja 12 mujore e pushimit të lehonisë, veçanërisht kur merren parasysh gratë që punojnë në sektorin privat dhe atë joqeveritar.

Të anketuarat mendojnë se është e rëndësishme të informohet publiku, të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave të grave, me problemet që punëdhënësit në sektorin privat krijojnë për gratë shtatzëna dhe gratë në punë. Është thelbësore të theksohet se publiku i gjerë duhet të jetë më i përkushtuar për të mbrojtur gratë shtatzëna

dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Gjithashtu, raste të shumta të zvogëlimit të padrejtë të të ardhurave, ndërrimit të turneve, zhvendosjes në një vend tjetër ose objekt pune brenda së njëjtës organizatë dhe situata të ngjashme u cituan gjatë pjesës cilësore të hulumtimit. Në një bisedë jozyrtare, të intervistuarat pranuan se qëndrimi në një gjendje tjetër ndikonte negativisht tek ata kur hasnin në kritika dhe presione nga shefat apo eprorët e tyre. Shumica e kolegëve meshkuj dhe femra thjesht shikonin në heshtje çdo mungesë respekti për gratë shtatzëna, sepse një sjellje e tillë është bërë përgjithësisht e pranuar. Në vend që të vënë në plan të parë sigurinë e kolegut të tyre, ata vendosin në vend të parë sigurinë e vendit të tyre të punës.

Në një pjesë të studimit, ne diskutuam gjithashtu nëse punëdhënësit e pushonin nga puna një punëtoare gjatë pushimit të lehonisë nëse mendonin se shpenzimet e shtatzënisë ose pushimit të lehonisë së gruas do të ishin një kosto shtesë për organizatën. Në këtë pjesë të hulumtimit, kemi hasur edhe një herë mbivendosje ndërmjet pjesës sasiore dhe cilësore të hulumtimit - rreth 60% e grave janë përgjigjur se kanë ditur shembuj të tillë ose kanë qenë vetë pjesë e një procesi të tillë.




"Ne jemi një shoqëri që jemi mësuar të qëndrojmë të heshtur, gjë që na bën të pambrojtur ndaj manipulimeve", theksoi një nga bashkëbiseduesit tanë.

Është gjithashtu më e lehtë për t'u menaxhuar kur kemi të bëjmë me individë të frikësuar, veçanërisht me nëna të tmerruara. Gratë duhet të inkurajohen çdo ditë për të raportuar punëdhënësit e pazgjidhur, si dhe për të krijuar organizata të specializuara në një formë inspektoratesh, roli i të cilave do të ishte monitorimi i kohës së rrezikshme pas pushimit të lehonisë. Tregimet dhe këshillat e rreme se gratë nuk duhet të padisin kurrë punëdhënësin e tyre kur të drejtat e tyre kërcënohen ose shkelen, dhe se më vonë askush nuk do të dëshirojë t'i punësojë ato ose ato do të jenë punëtoare të padëshiruara, duhet të zëvendësohen nga iniciativa të ndryshme për të trajnuar gratë dhe për të ofruar mbështetje për ata që guxojnë t'i raportojnë organeve kompetente për disa parregullësi.

Prandaj, gratë, si kategori tashmë vulnerabël, duhet të mbrohen gjatë gjithë marrëdhënies së punës dhe zgjidhja qëndron në rritjen e kontrollit mbikëqyrës mbi zbatimin e ligjeve tashmë ekzistuese. Gjithashtu, rishikimi i Ligjit të Punës do të kontribuonte shumë në përmirësimin e pozitës së grave, veçanërisht shtatzënave dhe grave në punë si kategoritë më të cenueshme.


